Kronikë

# Ushtroi dhunë ndaj bashkëshortes së tij, arrestohet 62-vjeçari në Mirditë! I sekuestrohet një armë gjahu dhe një sasi municioni luftarak

*Një 62- vjeçar është vënë në prangat e policisë ditën e sotme në Mirditë pasi ushtroi dhunë ndaj bashkëshortes së tij.*



*Arma e sekuestruar nga policia dhe sasia e municionit luftarak*

Redaksia
7 Qershor, 16:55 | **Përditesimi i fundit: 7 Qershor, 16:57**

***MIRDITË-*** Një 62- vjeçar është vënë në prangat e policisë ditën e sotme në Mirditë pasi ushtroi dhunë ndaj bashkëshortes së tij.

Pas kallëzimit nga bashkëshortja me iniciale F.Gj., 62 vjeç policia ka shkuar në banesën e 62-vjeçarit me iniciale Gj.Gj., në fshatin Gëziq ku i janë sekuestruar disa armë pa lejë.



LEXO EDHE:
**Lezhë/ Kultivonin drogë, arrestohen 2 persona, sekuestrohen 230 fidanë kanabis**

Policia ka sekuestruar një armë gjahu dhe një sasi municioni luftarak.

62-vjeçares F. Gj. iu lëshua urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes ndaj bashkëshortit të saj.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

***Njoftimi i policisë:***

Mirditë

Ushtroi dhunë ndaj bashkëshortes së tij, vihet në pranga 62-vjeçari.

Gjatë kontrollit në banesën e tij, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar një armë gjahu dhe një sasi municioni luftarak.

Nga specialistët për Hetimin e Krimeve ne Komisariatin e Policisë Mirditë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Gj. Gj., 62 vjeç banues në fshatin Gëziq, Mirditë, pasi ka bërë kallëzim bashkëshortja e tij, shtetasja F. Gj., se 62-vjeçari ka ushtruar dhunë ndaj saj.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesë, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar një armë gjahu, me leje, dhe një sasi municioni luftarak.

Shtetases F. Gj. iu lëshua urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

G.MO/Shqiptarja.com

TAG: Lezhe mirdite dhune ne familje

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**A po i mbajnë nën kontroll Bordet çmimet e hidrokarbureve e ushqimeve?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Kronikë

Izolohet zjarri në Reps të Mirditës, 54 forca zjarrfikëse bënë të mundur shuarjen e vatrës! Shmanget rreziku për banesat
7 Qershor, 08:26

Kronikë

Lezhë/ Futet për t'u larë në lumë, pëson atak kardiak, ndërron jetë 53-vjeçari
6 Qershor, 16:43

Kronikë

Zjarr i madh përshin pyjet pranë rrugës së Kombit (VIDEO)
6 Qershor, 16:39

Politikë

Tjetërsim i pronave në Lagunën e Kune-Vain, Gjykata e Lezhës lë në burg 3 të arrestuarit
6 Qershor, 14:35

Kultura

'UNUM' elektrizon bregdetin e Ranës së Hedhun! Mbi 10 mijë të rinj nën ritmet e muzikës elektronike
5 Qershor, 21:21

Sociale

Trafik i rënduar në rrugën që lidh Shëngjinin me aksin Lezhë-Milot, krijohet radhë kilometrike mjetesh
5 Qershor, 20:44

Kronikë

Elbasan/ Dhunonte bashkëshorten, e pajisur dhe me urdhër mbrojtje, arrestohet 34-vjeçari
5 Qershor, 10:51

Kultura

Muzikë dhe art, Shëngjini 'pushtohet' nga mijëra të rinj! Festivali 'Unum' bën bashkë turistë nga e gjithë bota
Elvis Hila
4 Qershor, 16:02

Sociale

Nis rehabilitimin rruga nacionale Milot-Fushë Krujë/ Prej 2 vitesh e degraduar, ARRSH nis rregullimin e rrugës
Elvis Hila
3 Qershor, 16:21

Kronikë

Identifikohen eshtrat e gjetura në Fushë-Kuqe të Kurbinit, i përkasin Mariglen Gjonajt, i zhdukur në 2015! ADN-ja u përputh me atë të mamasë së tij
3 Qershor, 15:36

Kronikë

Tjetërsim i pronave në Lagunën e Kune-Vain, arrestohet në Lezhë Drejtori i Zonave të Mbrojtura dhe 2 vartësit e tij! Në kërkim përgjegjësi i Monitorimit
3 Qershor, 14:43

Kronikë

Ra në kontakt me energjinë elektrike, merr flakë automjeti i ngarkuar me ushqim për bagëtitë në Lezhë
3 Qershor, 14:29




RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje